


**NDRYSHË, POR**



**TË BASHKUAR**

## DEMOKRACIA JONË

MONIKA (14), ALTIN (13), ELIZA (13), ALBAN (14), VALDRIN (14), JETMIR (13)



### Demokracia sot, nesër dhe përgjithmonë. Kjo është motoja jonë

Demokracia është udhëheqja që i bën populli një shteti. Mund të çuditeni se si populli e udhëheq shtetin, por është e vërtetë, se populli e udhëheq shtetin me anë të votës në zgjedhje të lira. Fjala demokraci rrjedh nga fjalët greke „demos“ që do të thotë popull dhe „kratia“ që do të thotë sundim ose udhëheqje. Demokracia filloi në vitin 507 para erës së re në Athinë, kryeqytetin e Greqisë. Atë kohë, vendime politike merrnin vetëm burrat e pasur, kurse këtë të drejtë nuk e kishin gratë, të varfërit, skllëvërit, etj. Por sot, në demokraci kanë të drejtë të marrin pjesë në vendimmarrje edhe gratë, të varfërit dhe nuk ka rëndësi ngjyra e lëkurës ose pamja, sepse të gjithë jemi të barabartë.

Një shtet demokratik ka për detyrë t'i sigurojë popullit të vet të drejtat themelore të njeriut. Disa nga këto të drejta janë: e drejta për të jetuar, e drejta për strehim,

e drejta për të folur lirshëm, e drejta për arsimim, e drejta për punësim, etj.

Shteti i Republikës së Kosovës, pasi që është shtet demokratik dhe i pavarur, ka për detyrë të na sigurojë të drejtën e shkollimit. Shteti këtë të drejtë na siguron duke na ndërtuar çerdhe publike, shkolla, objekte të fakulteteve, na siguron librat, bankat, karriget, etj. Të gjitha të mirat materiale që shteti na siguron neve, e bën për të na përgatitur për profesionet tona të ardhshme. Këto profesione që secili prej nesh i zgjedh vet do ta ndihmojnë shtetin e Republikës së Kosovës që të zhvillohet edhe më shumë.

Demokracia si formë e qeverisjes ndahet në dy forma, të cilat janë: demokracia e drejtpërdrejtë dhe ajo përfaqësuese. Demokracia përfaqësuese ndahet në demokracinë presidenciale dhe parlamentare. Ne jemi të lumtur t'iu tregojmë që bëjmë pjesë në demokracinë përfaqësuese parlamentare.



Ta mbajmë ambientin e pastër



Gazetarët e demokracisë

# NDARJA E DETYRAVE DHE PËRGJEGJËSIVE

BLINERA (13), DJELLZA (14), ALKETA (14), MALSOR (13), SHKUMBIN (13), ADIS (13)



## Lexues të nderuar, në këtë artikull do të mësoni se pse është e rëndësishme ndarja e detyrave dhe përgjegjësi në një shtet demokratik

Ndarja e detyrave në një shtet demokratik është shumë e rëndësishme, sepse secili institucion e ka mundësinë t'i kryejë detyrat dhe përgjegjësitë në mënyrë të pavarur. Sistemi i ndarjes së pushtetit në Republikën e Kosovës bëhet në tri degë: Pushteti Ekzekutiv, Pushteti Legjislativ dhe Pushteti Gjyqësor. Këto degë të pushtetit mundësojnë që qeverisja e një vendi të jetë shumë më e mirë.

Pushteti Legjislativ ushtrohet nga Kuvendi. Në Kuvend nxjerren dhe miratohen ligjet e ndryshme, të cilat ndikojnë për të mirë jetën tonë, si ligjet për arsim, shëndetësi, infrastrukturë, etj. Personat që merren me miratimin e ligjeve janë deputetët, roli i të cilëve është përfaqësimi i interesave të qytetarëve në Kuvend. Në Kuvend janë 120 deputetë, ku 20 prej tyre janë prej ko-

muniteteve jo shumicë, sepse Kuvendi e zbaton parimin më të rëndësishëm të demokracisë, e që është barazia.

Dega tjetër e pushtetit është Ekzekutivi, që ushtrohet nga Qeveria. Qeveria ka për detyrë zbatimin e ligjeve të marra në Kuvend. Në Qeveri marrin pjesë Kryeministri, ministrat dhe zëvendës ministrat.

Se a janë duke u zbatuar ligjet apo ka shkelje të tyre, është gjykata ajo që e përcjell këtë proces në mënyrë që gjithçka të shkojë në rregull. Pra, gjykata është dega e tretë e pushtetit. Në Kosovë janë tri lloje të gjykatave: Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme.

Këto ishin disa informata lidhur me ndarjen e pushtetit në Republikën e Kosovës dhe siç e kuptuat për të promovuar lirinë e shprehjes dhe qeverisjes së mirë, këto tri fuqi duhet të jenë të ndara dhe të punojnë në mënyrë të pavarur.



Ndarja e detyrave është demokraci



Gazetarët e demokracisë




# LIRIA DHE TË DREJTAT E QYTETARËVE

AURELA (15), ENIS (14), LEONIT (13), EDON (13), LEONITA (14), XHENETA (13)



**Qytetarë të dashur, ju keni të drejta dhe përgjegjësi sepse jetoni në demokraci. Për më shumë, lexojeni artikullin më poshtë**

Të jesh qytetar nuk do të thotë vetëm të jetosh në qytet. Qytetarë janë të gjithë personat që jetojnë brenda territorit të një shteti të caktuar. Kjo nënkupton se të gjithë ne jemi qytetarë të Kosovës. Po ashtu, jemi qytetarë të Kosovës sepse jemi të shënuar në regjistrin



civil. Përpos kësaj, ne kemi të drejtë të marrim pjesë në procesin zgjedhor që ndodh në vendin tonë.

Në rast se ne vendosim të shkojmë për vizitë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe aty janë duke u mbajtur zgjedhjet, ne nuk kemi të drejtë të marrim pjesë në këtë proces. Kjo sepse ne jemi qytetarë të Kosovës dhe jo të Amerikës. E kur jemi tek të drejtat, ne si qytetarë të një vendi demokratik kemi shumë të drejta. Ato janë: të votojmë, të shprehemi lirshëm, të kemi një identitet, të shkollohemi, etj. Megjithatë, nuk duhet

harruar se ne kemi edhe përgjegjësi ndaj vendit tonë. Përgjegjësitë tona si qytetarë janë: respektimi i ligjit, pagimi i taksave, respektimi i njëri-tjetrit, pastrimi dhe ruajtja e ambientit, ruajtja e pronave publike, etj.


Ne mendojmë se është e rëndësishme të jemi aktiv në demokraci. E aktiv mund të jemi në shumë mënyra. Marim shembull nëse një shkollë në një lagje të Prishtinës ka nevojë për një park, atëherë ne në klasën tonë organizohemi dhe në mënyrë vullnetare mbjellim fidane të ndryshme.

Megjithatë, siç e cekëm, kjo nuk është forma e vetme se si mund të jemi aktiv. Aktiv mund të jemi edhe duke marrë pjesë në procesin zgjedhor, duke qenë i angazhuar në organizata të ndryshme që i mbrojnë të drejtat e njeriut apo fëmijëve, duke marrë pjesë në tubime publike apo edhe duke nënshkruar peticione.


Ne ju ftojmë që të jeni aktiv në vendin tonë dhe asnjëherë të mos ndalemi.



Gazetarët e „Demos-ti“



Të drejtat tona mbrohen



Të bashkuar jemi më të mirë

**Mësojeni se pse mediat luajnë një rol të rëndësishëm në demokraci.**

**Ju ftojmë të lexoni artikullin më poshtë**

Në demokraci, populli duhet të jetë i informuar. E mediat shërbejnë pikërisht për informimin e popullit. Pra, e kuptojmë që mediat janë të pazëvendësueshme në jetën tonë. Ato janë pjesë e përditshmërisë sonë dhe tashmë janë bërë pjesë e jona. Falë mediave ne e dimë se çfarë ndodhë në vendin tonë, por edhe në tërë shtetet e tjera të botës. Sikur të mos ishin mediat, ne me shumë vështirësi do ta kuptonim se kush është bërë kryetar i një komune tjetër, në të cilën nuk kemi qenë asnjëherë. Mediat kanë përgjegjësi të na informojnë drejt dhe të gjitha lajmet të jenë korrekte dhe të sakta.



Mediat janë pjesë e përditshmërisë sonë. Ato na informojnë dhe na e lehtësojnë jetën tonë





## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:  
Tel: +381 38 704 560  
E-mail: [info@demos-ti.org](mailto:info@demos-ti.org)  
Website: [www.demos-ti.org](http://www.demos-ti.org)

Pjesëmarrësit:  
SHFMU „Zenel Hajdini“  
Klasa: VIII-1  
Vendi: Prishtinë